



BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

Denib Kombit i bdeeb është Shqipëria. Tës chutu është herretës
gjitha lumbat që bëjnë: qas te bëtë digjitet: en se bëtë qëndrues.
En leb dafshi se bëtë botele foneb dellë mesfondgjeneb per sira mureb
me vërtinues. A t'ës. Editura pach mendete e atunët këtë endiqës
gjimeb. Për leb atab teb mundeb mernëb: qaa bë nolle e bësimtunë
është mësferëtum amfë fotonë. Etunët këtë duone em këtë fëmire gjuhë
ëmbas fodi ma spesë teb vullë em cilësë per se bëtë qëndrues. Fëmire orën heqë
në; et; e zëtë neb e barri ofisë. Fotunët këtë çetëtë mësferët emillimi e tashë: këtë

Harta e faqes

PËRSHKRIMI	KATALOGËT	KOLEKSIONET	SHËRBIMET	BOTIMET	NGJARJE	DREJTORI	KONTAKTE
------------	-----------	-------------	-----------	---------	---------	----------	----------

Ngjarje

Arkiv

Botimet e Bibliotekës Kombëtare kushtuar De Radës prezantohen në hapësirën arbëreshe

Maq, 21 gusht 2015



Në edicionin e dytë të takimeve vjetore me titull "Takohemi Maq"/"Incontriamoci a Macchia", organizuar nga Shoqata Kulturore Arbëreshe "J. De Rada", në bashkëpunim me Fondacionin Universitar "Francesco Solano" të Universitetit të Kalabrisë, mbajtur në Maq (San Demetrio Corone) më 21 gusht, u prezantuan dy botime të rëndësishme të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë kushtuar De Radës. E ftuar për këtë prezantim ishte Drejtoria e BKSH-së, Prof. Dr. Persida Asllani, e cila prezantoi botimin anastatik antologjik "De Rada në shtypin shqiptar 1887-1944", botim i përbashkët me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" si dhe numrin e ri të revistës shkencore të Studime Albanologjike, të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Ajo theksoi që në fillim se një nga vlerat më të rëndësishme të "Vitit kulturor De Rada" në përkujtim të 200-vjetorit të poetit ishte ndryshimi cilësor që solli në jetën kulturore e akademike në të gjithë hapësirën mbarëkombëtare, duke e shndërruar De Radën në një katalizator të ri jetës kulturore mbarëkombëtare e cila vijon edhe përqej kalendarit të kretimeve.

Duke prezantuar botimet e përgjedhura, Znj. Asllani sqaroi se botimi anastatik "De Rada në shtypin shqiptar 1887-1944" shenjon një homazh që dy Bibliotekat kombëtare, ajo e Shqipërisë dhe ajo Kosovës ndërmorën në kremitmet e 200-vjetorit të De Radës. "Libri – vijoi ajo-, është menduar si një antologji e përgjedhur e shkrimeve dhe komenteve më të bukura kritike të botuara në shtypin kulturor shqiptar, duke sjellë kështu në vëmendjen e publikut, tashmë edhe arbëresh, jo vetëm kontributet e kritikës përmes emrave më të spikatur të saj, por edhe ndjeshmérinë e veçantë që gëzonte veprat dhe emri i De Radës në botën kulturore shqiptare deri në vitin 1944".

Ndërsa Nr. 2/2014 i revistës "Studime Albanologjike" u prezantua si një arritje e suksesshme studimore përmes bashkëpunimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë me Departamentin e Letërsisë të Fakultetit të Historisë e Filologjisë të Universitetit të Tiranës, duke përfshirë botimin e bibliografisë: "Jeronim de Rada në tekstet shkollore shqiptare 1912-2014", kontribut i Shkollës Doktorale të Departamentit të Letërsisë dhe i specialistëve të Sektorit të Bibliografisë Kombëtare të BKSh-së. Znj. Asllani vuri në dukje për të pranishmit e shumtë se përmes kësaj bibliografie u jepet specialistëve të letërsisë, por sidomos atyre të metodologjisë së mësimdhënies, një instrument i vlefshëm për të

kuptuar dhe modernizuar procesin e njohjes së autorëve arbëreshë e më gjerë. Përfundimet më cilësore vijnë nga vetë kontributet e doktorantëve, botuar së bashku më studime të tjera të pedagogëve të tyre në këtë numër, si akte të konferencës "Rikthimi te Poezia e De Radës".

Por edicioni II i "Takohemi Maq" vijoi edhe me veprimitari të tjera duke u shquar denjësisht tashmë si një faktor i rigjallërimit jo vetëm të jetës kulturore në botën arbëreshe por edhe të bashkëpunimit të shumëanshëm mes Institucionesh e strukturash kulturore mbarëkombëtare. Presidenti i Shoqatës Kulturore Arbëreshe "J. De Rada", zoti Ernesto Madeo parashtrroi planveprimin e shoqatës në krijimin e një Parku letrar arbëresh, dhe theksoi domosdoshmërinë e mbështetjes së specializuar por edhe institucionale në vijim nga ana e institucioneve shqiptare.

Gjithashtu, një nga panelet shumë interesante të Edicionit II të "Takohemi Maq" ishte debati "Gjuhë e mira e gjuhë të këqija" në kuadër të reformës së RAI-it në lidhje me gjuhët e minoritetave. Ky debat trajtoi problematikën e reformës dhe vuri në dukje nevojën e një veprimi të koordinuar kulturor, gjuhësor, ligjor e social në mbrojtje të transmetimit televiziv arbërisht në RAI. Pjesëmarrës në debat ishin Profesori i mirënjohur Françesko Altomari (Universiteti i Kalabrisë dhe President i Fondacionit Universitar F. Solano); Profesor Giovanni Cimbalo (Universiteti i Bolonjës); Emanuela Capparelli (Presidente e Fondacionit Rajonal Arbëresh) dhe Demetrio Crucitti (Drejtor rajonal i RAI Calabria). Promotor i rëndësishëm jo vetëm i shumë projekteve studimore por edhe bashkëpunimesh të suksesshme mes studiuesish e institucionesh mbarëkombëtare, Profesor Altomari e cilësoi "të drejtën e një komuniteti për të folur gjuhën e vet" si një shpallje dhe të drejtë universale të dinjitetit njerëzor.

Tipike e këtij takimi është edhe pjesa muzikore, në të cilën u shpalosën këngët, vallet dhe kostumet e bukura arbëreshe, përmes performancës së grupit "Lulet e rea" dhe mjeshtrit Ernesto Iannuzzi si edhe prezantimi gastronomik i specialitetave të kuzhinës arbëreshe dhe, veçanërisht këtë vit, i produkteve unike të "Derkut të zi" (suino nero).

I organizuar në sheshin ku ngritet Kisha në të cilën prehet sot De Rada, dhe përgjatë rrugës që mban emrin e poetit, ndonëse në edicionin e tij të dytë, tashmë "Takohemi Maq", vendlindje e De Radës, prenton të kthehet në një aktivitet bosht të jetës kulturore e turistike të botës arbëreshe dhe asaj mbarëshqiptare.





